



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 12.6.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Nezir Çoçaj, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Glauk Konjufca dhe Igor Simiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Berisha, OSBE; Fitore Sopjani, praktikante, Zyra për Informim; Rreze Hoxha, GLPS; Besiana Bajrami dhe Rron Agolli, “Ekonomia Online”; Dibran Istrefi, Klan Kosova; Ediar Krasniqi, KDI; Albulena Mavraj, “Epoka e Re”; Muharrem Saragorni, Radio Kosova; Blerim Sallahu, Kuvendi i Kosovës; Agim Maraj, Ambasada Britanike; dhe Shefki Kastrati, NDI.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 2.5.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme;

4. Diskutim për Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Plani i Veprimit;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin-06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.06/L-040 për masat mbrojtëse në importe;
9. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.06/L-038 për shërbimet postare;
10. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Hajdar Beqa**, propozoi që pika 3 e rendit të ditës, Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, të hiqet nga rendi i ditës dhe i njëjti të mos vendoset në rend dite, derisa të kemi edhe projektligjin nga Qeveria, që përfshin qëllimin e përbashkët, i cili pritet të miratohet në Qeveri dhe së shpejti mund të vijë në Kuvend.

**Kryetarja**, tha se Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes e ka marr iniciativën për këtë projektligj, duke pohuar se rregullon krejt diçka tjetër nga propozimi i Ministrisë së Drejtësisë, sepse propozimi i ministrisë lidhet me vepër penale dhe jo me barrën e provës që nuk e vendos te personi i dyshuar, ashtu siç e ka propozuar Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit ta përkrahin nismën e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes.

*Propozimi i z. Beqa u miratua me 5 vota për dhe 3 kundër, ndërsa kryetarja e komisionit nuk mori pjesë në votim.*

*Kryetarja, pas diskutimeve, konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshime, pasi u hoq nga rendi i ditës pika tre e rendit të ditës, sipas propozimit të z. Beqa, me 8 vota për dhe 1 kundër.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 2.5.2018**

**Kryetarja** konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më dt. 2.5.2018.

### **3. Diskutim për Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Plani i Veprimit**

**Kryetarja**, tha se Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit është miratuar më 23.0.2018 nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Qeveria e ka miratuar dhe menjëherë ka hyrë në fuqi, pa e sjellë fare në Kuvend. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsion parasheh që Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsion e miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pasi kam kërkuar, e kanë sjellë këtë

dokument, por vendimin nuk e kanë ndryshuar dhe ne nuk guxojmë që të miratojmë diçka me këtë vendim. Po ashtu, tha se i kishte kërkuar Qeverisë që ta shfuqizojë këtë vendim dhe ta sjellë vendimin tjetër, në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit, por ende ka marrë përgjigje nga Qeveria. Më tej, shtoi se nëse ky dokument mbetet në dosje, përveçse është i kundërligjshëm, por edhe ne nuk guxojmë të lejojmë vendime të tilla. Në fund, tha se jam që sa më parë të kalojë Strategjia Kundër Korrupsionit, por Qeveria duhet të tregohet sa më vigjilente dhe të respektojë legjislacionin që është në fuqi dhe gjatë kësaj jave presim nga Qeveria që ta shfuqizojë këtë vendim dhe të sjellë një vendim tjetër, në përputhje me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

**Shkumbin Demaliaj**, tha se nëse ka kolizion ligjor brenda këtij vendimi dhe hyrjes në fuqi dhe duhet të miratohet nga Kuvendi, duke pohuar se secili dokument që i vjen Kuvendit për shqyrtim nga Qeveria, për miratim, duhet të nënshkruhet, andaj nëse ka kolizion ligjor, duhet t'i kthehet Qeverisë. Po ashtu, theksoi se nëse ka ndodhur parregullsi gjatë procedimit, është mirë që ne mos ta shqyrtojmë, nëse nuk është edhe në kompetencën tonë, që është nënshkruar paraprakisht dhe nuk bazë ligjore. Në fund, tha se është kërkesë e jona që të rregullohet proceduralisht dhe ligjërisht.

**Arben Gashi**, tha se po krijohet një precedent i gabuar nëse Kuvendi miraton një vendim që është në fuqi dhe njëkohësisht i zbatueshëm nga dt. 23.3.2018. Po ashtu, tha se duhet një sqarim ligjor nga Zyra e Kryeministrit për të kuptuar sesi ka hyrë në fuqi një dokument, i cili nuk ka mundësi të hyjë në fuqi sipas Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Pra, institucionalisht, logjikisht Kuvendi nuk miraton dokumente që janë në fuqi, përderisa po zbatohet, andaj duhet t'ia dërgojmë Zyrës së Kryeministrit, për sqarim.

**Sami Kurteshi**, tha se po krijohet një precedent i rrezikshëm dhe ky dokument duhet të rregullohet sa më shpejt, në aspektin ligjor.

**Korab Sejdiu**, propozoi që kjo pikë të hidhet në votim, pasi që ka një konsensus të gjerë që t'i kthehet Qeverisë për shqyrtim, duke pohuar se nëse diskutojmë më tutje në përmbajtje, duket qartë që ka defekt juridik.

**Kryetarja** theksoi se si kryetare e komisionit i kam shkruar që është problem ligjor, sepse ka pasur akuza që komisioni nuk po e procedon tutje. Prandaj, edhe e kam sqaruar situatën, por ende nuk ka përgjigje dhe ndoshta është më e fuqishme, nëse ne e adresojmë problemin, si komision.

**Arben Gashi**, sqaroi se agjencia nëpërmjet Qeverisë, i propozon Kuvendit Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe mendon se duhet të kthehet te propozuesi.

**Hajdar Beqa**, tha se ligji është shumë i qartë dhe nuk besoj se kemi arsye për të diskutuar më për këtë, pasi që kemi unitet në komision, atëherë komisioni vendos që t'ia kthejë Qeverisë dhe pastaj ata të veprojnë sipas ligjit.

*Kryetarja, pas diskutimeve, konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që mos ta shqyrtojë këtë dokument, pasi që të konsultohen edhe një herë me Qeverinë, dhe nëse bëhet fjalë për lëshim teknik, të njëjtin ta procedojnë për Kuvend për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi, siç përcaktohet me nenin 16 të Ligjit nr. 03/L-159 PËR AGJENCINË KUNDËR KORRUPSIONIT.*

#### **4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin-06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

#### **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

#### **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

*Meqë pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:*

### **REKOMANDIM**

Të përfshihen në raportin e Komisionit FunkSIONAL edhe amendamentet e deputetëve me ose pa përkrahjen e komisionit.

#### **7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.06/L-038 për shërbimet postare**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-038 për shërbimet postare dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

## **REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 06/L-038 për shërbimet postare dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

### **9. Të ndryshme**

*Në pikën të ndryshme nuk pati ndonjë gjë për diskutim.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**